



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK



Nr _____ Prot

V E N D I M

Vau Dejes me _____ / _____ 2020

Nr. 38 Datë 25.062020

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 4, të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr 38/2019, ligji nr 8744 datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, ndryshuar, në VKM nr 68 datë 28.01.2008, “për miratimin e listes përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunes Bushat, Bashkia Vau Dejes, të Qarkut Shkoder”, në VKM nr 54 datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të mënyrës së dhënjes me qira, enfteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar.

Si dhe pas shqyrtimit te projekt -vendimit nr 01 date 07.05.2020, paraqitur nga Drejtoria Juridike Prokurimeve dhe Integritimit, Sektori Aseteve, ku propozohet ti jepet me qira banorit Tom Shkreli një sipërfaqe toke prej 100m2 (shesh +truall), pronë e Bashkisë Vau Dejes. Pas diskutimit dhe miratimit me shumicë të cilësuar të votave.

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I

1. Miratimin e dhënjes me qira të një sipërfaqe toke (shesh+truall), prej 100m2 banorit Tom Shkreli.
2. Afati i dhënjes me qira është 1 vjeçar, me të drejte rinovimi.
3. Vlera e dhënjes me qira të kësaj pasurie është: 100m2 x 100 l/m2 = 10 000 (dijetemijë) leke/muaj, referuar VKM- nr 54. date 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të mënyrës së dhënjes me qira, enfteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore”, ndryshuar
4. Ngarkohen Drejtoria Juridike Prokurimeve dhe Integritimit, Sektori i Aseteve, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

K R R Y E T A R

Sekretari i Këshillit Bashkik

Miratuar me 20 vota

Vota Pro 20

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me date 01/07/2020